



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Sigurinë Kombëtare***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 09.07.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës :**

1. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 01-19 korrik 2019.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës”.

**Marrin pjesë:**

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Elona Hoxha, Myslim Murrizi, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Lefter Maliqi, Ylli Shehu, Luan Harusha, Antoneta Dhima, Elena Xhina, Eljo Hysko, Anduel Xhindi dhe Arben Elezi.

**Mungojnë:**

Paulin Sterkaj, Alban Zeneli dhe Edmond Rrushi

**Të ftuar:**

Fjoralba Caka - Zëvendësministre e Drejtësisë

Edis Ibrahim - Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë

Bernard Duro - Drejtor i Zyrës Vendore në Tiranë

Ilir Bejko - Drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

## HAPET MBLEDHJA

**Ermonela Felaj** – Mirëmëngjesi, kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje kemi përcaktuar miratimin e kalendarit të punës së komisionit për periudhën 1 korrik deri më 19 korrik 2019. Realisht është një kalendar i njohur për kolegët, sepse është miratuar më parë në parlament.

Si pikë të dytë kemi shqyrtimin e projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”. Ju kujtoj se ky është një projektligj i ri, nuk sjell ndryshime në ndonjë ligj tjetër, për shkak se Shërbimi i Provës deri në momentin aktual, që prej 10 vjetësh është rregulluar me një vendim të Këshillit të Ministrave dhe një rregulloreje përkatëse për organizimin dhe funksionimin e tij. Pra, në këtë pikëpamje është një risi prezantimi i tij në Kuvendin e Shqipërisë. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Komisioni përgjegjës për këtë projekt është Komisioni i Ligjeve.

Për të bërë prezantimin e këtij projektligji kemi të ftuar përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, konkretisht: zonjën Fjoralba Caka, zëvendësministre e Drejtësisë.

Faleminderit zonja zëvendësministre!

Zotin Edis Ibrahimi, këshilltar i ministrit, zotin Bernard Duro, drejtor i Zyrës Vendore në Tiranë, si dhe zotin Ilir Bejko, drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

Relator për këtë projektligj është zoti Qefalia.

Ndërkohë do t’i jap fjalën zonjën zëvendësministre për të na bërë një prezantim të projektligjit, se çfarë parashikon ai, cilat janë risitë e punës së Shërbimit të Provës sipas këtij projektligji, si është punuar nga ana juaj, çfarë modelesh janë konsultuar për këtë projekt dhe nëse është bërë konsultimi publik. Pra, të gjitha këto momente të rëndësishme që lidhen me punën për hartimin e një projekti të tillë.

Fjala është për ju.

**Fjoralba Caka** - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë!

Është kënaqësi për mua të jem sot para Komisionit për Sigurinë për të prezantuar një ligj të rëndësishëm siç është ai për Shërbimin e Provës, i cili vjen si një ligj i paketës peniteciare të përbërë edhe nga 5 ligje të tjera. Nevoja për këtë nismë erdhi së pari, sepse mungonte një ligj për rregullimin e Shërbimit të Provës, pasi që nga viti 2009 ky shërbim ka qenë i rregulluar me VKM-në, nr. 302, datë 25.03.2009.

Nevoja për të rregulluar këtë shërbim me ligj nuk erdhi thjesht për t'iu përgjigjur nevojës për siguri juridike, qoftë për institucionin, qoftë për subjektet, por ka ardhur edhe në sajë të rekomandimeve të KE-së, me rekomandimin e vitit 1992/16. Në rregullin nr.7 përcaktohet që autoritetet përgjegjëse për zbatimin e masave dhe të sanksioneve komunitare duhet të rregullohen me ligj. E njëjta gjë është përsëritur edhe në rekomandimin e vitit 2001 të Komitetit të Ministrave në rregullin nr. 8, ku kërkohet që shërbimet e provës në vendet e KE-së të rregullohen me ligj.

Së dyti, nevoja për këtë ligj erdhi edhe nga problematikat e hasura në praktikë, por edhe nga pikëpamja teorike në veprimtarinë e Shërbimit të Provës dhe për më tepër nevoja për rishikimin e këtij ligji erdhi edhe në kuadër të paketës peniteciare e përbërë nga 5 ligje të tjera, konkretisht: ligji “Për të drejtat e të dënuarave dhe të paraburgosurve”, ligji “Për Policinë e Burgjeve”, ligji “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në burgje”, si dhe ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Një pjesë e rregullimit të Shërbimit të Provës gjendet edhe në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Kjo pjesë do të shfuqizohet, sepse tashmë Shërbimi i Provës do të rregullohet me një ligj të posaçëm. Ligji i ka kaluar të gjitha hapat e konsultimit publik dhe në datën 19.06.2019 me qëllim marrjen e mendimeve apo sugjerimeve është publikuar në *website*-in e ministrisë. Pas kalimit të afatit 20 -ditor nga publikimi i përcaktuar, pasi nuk u përcoll asnjë koment, ne kaluam në vendosjen e projektligjit në e-akte për të marrë edhe konsultimin e ministrive përkatëse. Konkretisht të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të Ministrisë së Brendshme, të Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin dhe të Departamentit të Administratës Publike.

Komentet e përcjella nga DAP-i u pasqyruan dhe u reflektuan në këtë projektligj. Ministria e Brendshme është shprehur dakord në parim për projektligjin, po ashtu edhe Ministria e Financave. Për këtë projektligj njëkohësisht janë organizuar tryeza dhe diskutime me pjesëmarrës nga shoqëria civile, nga OJF-të e ndryshme, përfshirë donatorë dhe organizata ndërkombëtare si OSBE-në, që kanë paraqitur komente për draftligjin.

Lidhur me nevojën për të pasur një ligj të ri dhe risitë, do të thosha se ky ligj synon të rregullojë organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës, të përcaktojë procedura për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative, trajtimin e individualizuar të nevojave dhe të aftësive të personit të mbikëqyrur dhe riintegrimin e tij në jetën shoqërore. Këta objektiva realizohen nëpërmjet bashkëpunimit efektiv të organeve të drejtësisë penale, por mbi të gjitha përmes një lidhje të veçantë që ky projektligj do të krijojë midis punonjësit të Shërbimit të Provës dhe të mbikëqyrurit për të siguruar zbatimin e misionit të Shërbimit të Provës që është riintegrimi i personit në jetën sociale dhe ekonomike të vendit.

Në aspektin teknik ligji njeh dhe vazhdon trajtimin e individualizuar të personave që trajtohen nga Shërbimi i Provës, duke pasur parasysh nevojat e veçanta të kategorive të caktuara, sidomos të të miturve. Është politikë dhe strategji e kësaj qeverie që dënimi me burg do të jetë *Extrema Ratio*, masa e fundit që do të merret pasi janë shqyrtuar dhe janë marrë të gjitha masat alternative. Kjo vlen veçanërisht për personat e mitur dhe shkon në të njëjtën linjë edhe me Kodin për të Miturit, që kërkon zbatimin e masave alternative, sidomos në ato raste kur ligji detyron kur sanksioni është deri në 7 vjet për të bërë të mundur riintegrimin e tij në shoqëri. Jo vetëm kaq, por qasja e politikëbërësit në këtë rast Ministria e Drejtësisë është që në rast se kemi një reagim të ashpër ndaj të miturit duke e vendosur atë në burg dhe jo duke zbatuar masa alternative, kjo mund të sjellë pasoja të parikuperueshme të ky individ duke e kthyer atë jo vetëm në një përsëritës, por edhe duke e drejtuar ndoshta në lidhje kriminale nga të cilat mund të burojnë vepra më të rënda sesa ato që ishte burgosur personi fillimisht.

Për këto arsye misioni i këtij ligji është drejtimi, dhënia e ndihmës dhe përkrahja e personave të dënuar në pajtim me parimet e drejtësisë restauruese që është një nga ndryshimet që është bërë, si në Kodin Penal, por edhe filozofia kryesore e Kodit Penal për të Mitur.

Vlen për t'u theksuar se në prezantimin e këtij projektligji kemi një rregullim specifik në nenin 6 për asistimin në lidhje me strehimin dhe punësimin, ku punonjësit e Shërbimit të Provës jo vetëm do të kujdesen për ekzekutimin e vendimit penal, por do të asistojnë dhe do të ndihmojnë personat që janë në shërbim prove për t'u integruar, për të gjetur punë në të ardhmen dhe për të siguruar strehim. Për të bërë këtë, neni 11 parashikon se personat që do të punojnë në Shërbimin e Provës duhet të kenë kualifikim të veçantë, qoftë në edukim, ku përfshihet studimi me master dhe në fusha specifike, siç janë: drejtësia, punët sociale dhe psikologjia. Duke rekrutuar personat që janë të specializuar në fusha të veçanta, ne do të bëjmë të mundur nëpërmjet këtij projektligji jo thjesht zbatimin e detyrimit ligjor dhe të masave alternative, por asistimin e individualizuar të çdo personi për t'u përshtatur ndaj sfidave kur ai del nga Shërbimi i Provës.

Punonjësit e Shërbimit të Provës duhet të analizojnë edhe shkaqet që kanë sjellë shkeljen dhe të bëjnë një prognozë të rasteve recidiviste. Për këtë arsye kërkohet edhe një arsim specifik nga ana e tyre.

Projektligji parashikon detyrimin për punonjësit e Shërbimit të Provës që të kujdesen maksimalisht edhe për të dhënat personale të personave që ata mbikëqyrin. Kujdesi për të dhënat personale, veçanërisht i regjistrit është një detyrim që buron jo vetëm nga ky ligj, por edhe nga ligji "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Nga pikëpamja organizative Shërbimi i Provës është konceptuar me një drejtori qendrore dhe 22 degë të decentralizuara të quajtura degë territoriale, të cilat do të jenë të atashuara pranë gjykatave. Atashimi pranë gjykatave bën të mundur edhe me mbështetjen e drejtorisë unifikimin e praktikave të Shërbimit të Provës, shmangien e rasteve të paunifikuara dhe të veçanta në trajtimin e Shërbimit të Provës.

Punonjësit e degëve territoriale kanë funksione zbatuese duke ruajtur evidenca të qarta të rasteve që trajtojnë dhe duke propozuar zgjidhjet që ata i konsiderojnë optimale.

Ndërkohë rregulla më të hollësishme për funksionimin dhe organizimin e këtij instituti do të përfshihen edhe në rregulloren e përgjithshme të Shërbimit të Provës, e cila është një dispozitë referuese brenda këtij ligji.

Kjo është thjesht për të shpjeguar se çfarë synon ky projektligj. Me lejen tuaj mund të bëj edhe një analizë të shkurtër, nen për nen, por gjenden në relacion, prej të cilit i është servirur nga një kopje gjithë anëtarëve të komisionit.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit për prezantimin!

Fjalën e ka zoti Qefalia.

**Xhemal Qefalia** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja zëvendësministre! Ishit shumë shteruese në gjithë informacionin që paraqitët lidhur me projektligjin e ardhur në komision.

Të nderuar kolegë, ky është një projektligj që vjen si domosdoshmëri e ndryshimeve që ka pësuar legjislacioni penal shqiptar, sidomos në kuadrin e reformës në drejtësi.

Siç e tha edhe zëvendësministrja, që nga viti 2009 nuk është punuar me një ligj të veçantë, por është punuar vetëm me një VKM të Këshillit të Ministrave. Nisur nga problematika e ndryshimeve të konstatuara, por edhe e praktikës së deritanishme, qoftë teorike, qoftë praktike, vjen si domosdoshmëri hartimi i këtij projektligji kaq të domosdoshëm.

Në mënyrë të përmbledhur, unë po jap vetëm disa nga objektivat kryesore që synon ky projektligj, i cili do të ndihmojë drejtpërdrejt për hartimin e një kuadri të plotë të sistemit penitenciar. Siç e përmendi edhe zëvendësministrja, janë disa ligje të cilat normojnë punën dhe aktivitetin e sistemit penitenciar. Ky ligj përmbush kuadrin ligjor për mbarëvajtjen e këtyre individëve, për të cilët gjykata vendos që pjesën e mbetur të dënimit ta kalojnë në shërbimin e provës.

Ndër objektivat konkrete, pikësëpari është harmonizimi dhe unifikimi i ndryshimeve të parashikuara në Kodin Penal. Së dyti, do të ketë një reduktim të dukshëm të kostove sociale të dënimeve penale. Së treti do të ketë një ndjeshmëri të madhe për sa i përket

bashkëpunimit me organizatat e tjera publike e private, përfshi këtu edhe persona të tjerë, të cilët gjatë kohës janë duke ushtruar shërbimet në provë. Forcimi i mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimeve alternative. Një trajtim i individualizuar i nevojave dhe aftësive të personit për mbikëqyrjen, për t'i riintegruar ata në jetën shoqërore. Përcaktimi i qartë dhe konkret i detyrimeve për punonjësit e shërbimit të provës. E ajo që është finalja, që ka ndjeshmëri dhe fleksibilitet edhe në opinionin shoqëror, është rritja e numrit të dhënies së dënimeve alternative nga gjykata. Pra, reduktimin e burgut, që jo çdo masë dhe vepër penale e kryer të mos përkthehet në burg, por të kalohet te shërbimi i provës, pasi kjo pakëson në mënyrë të ndjeshme dramat sociale që krijohen në familje.

Në këtë kuadër, në mënyrë të përmbledhur, të nderuar kolegë, mendoj se duke e miratuar ne si Komision i Sigurisë, jo vetëm rrisim masat e sigurisë, por ndikojmë dukshme dhe në trajtimin e këtij kontingjenti, i cili është duke kaluar dënimin e dhënë të shërbimit në provë. Njëkohësisht, kjo do të harmonizojë më së miri edhe të gjitha ligjet dhe kuadrin ligjor, që normojnë punën në këto institucione.

Kësisoj, ju ftoj që ta votojmë këtë projektligj, pasi ndikon drejtpërdrejt edhe në rritjen e sigurisë kombëtare.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, koleg!

Është e qartë se bëhet fjalë për një projekt që nevojitej. Kjo edhe për arsyen e thjeshtë se Shërbimi i Provës është institucion që kontribuon në sigurinë publike nëpërmjet përkrahjes apo qëllimit që ka në funksionimin e vet, për të rehabilituar e riintegruar në shoqëri të gjithë personat e dënuar.

Kuptohet, performanca sa më e mirë e institucionit të Shërbimit të Provës, e lidhur edhe me parashikimet më të mira ligjore, do të sigurojë nivelin më të lartë në arritjen e këtij qëllimi.

Kolegë, përpara se të kalojmë në votimin në parim, sigurisht që kemi diskutimin në parim, kështu që e çelim diskutimin për pyetje.

Po, zoti Murrizi.

**Myslym Murrizi** – faleminderit, zonja kryetare!

Nëse ka informacion, do të doja të dija: nga viti 2009 deri më sot, pra tash dhjetë vjet që funksionin me VKM, sa është përqindja totale e këtyre që janë trajtuar nga shërbimi i provës, në krahasim me numrin e të dënuarve që janë në institucionet e riedukimit, në burgje?

Thatë se kemi 22 degë Shërbimi të Provës. Çfarë është pasur parasysh në krijimin e një dege të Shërbimit të Provës? Numri i gjykatave, numri i institucioneve të vuajtjes së dënimit, apo janë krijuar në prag të fushatës? Sepse në vitin 2017 vetëm rrethi i Lushnjës ka

pasur njëmbëdhjetë vetë të punësuar me aksion, gjatë dy javëve të fundit, nga ish-ministri i LSI-së.

Nëpërmjet medieve, jo se kam qenë i azhurnuar në ministrinë tuaj, di se ka qenë ai fenomeni i famshëm i humbjes së byzylyqeve apo i blerjes, se nuk e di çfarë ishte. A mund të na shpjegoni ndonjë gjë konkretisht në lidhje me ato byzylyqet që mbajnë këta të përndjekurit, këta që ndiqen nëpërmjet Shërbimit të Provës?

Sa është numri total i të gjithë punonjësve të Shërbimit të Provës, ku përfshihet Drejtoria e Përgjithshme dhe 22 degët e rretheve?

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Po, zonja Caka! Fjala është për ju!

**Fjoralba Caka** – Faleminderit, zoti Murrizi!

Po i marr një e nga një pyetjet e parashtruara prej jush. Lidhur me numrin e personave që janë subjekte të Shërbimit të Provës nga 2009-a deri më sot, në 2009-ën totali ka qenë 705 persona, të cilët mund t'i kategorizoj. 705 persona në 2009-ën. Nëse doni, mund të bëj edhe një specifikim. Prej këtyre, 571 kanë pasur masën e pezullimit, 6 kanë pasur masën e qëndrimit në shtëpi, 76 kanë pasur lirin me kusht, 52 punë me interes publik, dhe zero vetë me gjysmë lirie. Statistikat e fundit tregojnë se numri total në 2018-ën ka vajtur në 7 mijë e 528 persona. Aktualisht, në total janë 38 mijë e 462 vetë.

Kjo tregon edhe një herë qasjen për të mos shkuar te ndëshkueshmëria me burg, që është masa *extrema radio*, masa e fundit që duhet marrë, siç parashikon Kodi Penal, por në aplikimin e masave alternative të dënimit, si mënyra më e përshtatshme për t'u trajtuar personat që kanë kryer një shkelje apo një vepër penale.

Pra, ky progres i madh tregon rëndësinë që ne i kemi kushtuar Shërbimit të Provës në vite.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vetë Kodi Penal e thotë shumë qartë që, gjykata dhe prokuroria, para se të shkojnë te ndëshkimi me burg, duhet të aplikojnë masat alternative të dënimit, vetë Kodi Penal e parashikon se burgimi është masa e fundit që do të merret, kur masat e tjera nuk janë të përshtatshme.

Rregullimi ligjor që ne kemi bërë, në njëfarë mënyre i detyron institucionet ligjzbatuese për të ndjekur këtë metodologji në ndëshkimin e personave.

Lidhur me pyetjen e dytë, se përse kemi 22 degë shërbimi, në fakt është diskutuar edhe gjatë hartimit të këtij ligji, se si do të bëhet kjo ndarje territoriale: do të kemi njësi, do të kemi degë territoriale? Po ta vini re, termi që kemi përdorur në ligj, është: degë territoriale, që shkon në të njëjtën linjë edhe me ligjin “Për organizimin e qeverisjes vendore. Janë zgjedhur

pikërisht 22, bazuar tek gjykatat. Pra, jo bazuar te veprimtaria e organeve të qeverisjes vendore, por bazuar tek gjykatat. Kjo është bërë për të pasur afritet, por njëkohësisht për të ndjekur në mënyrë uniforme zbatimin e vendimeve të gjykatave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pra, ka qenë gjykata ajo që na ka motivuar për t'i ndërtuar këto shërbime në 22 degë territoriale.

Lidhur me pyetjen e tretë që shtruat, për çështjen e byzylykëve, pa ju bërë një memo të gjatë lidhur me mënyrën se si ndodhën gjërat, dhe se çfarë ka ndodhur nga viti 2017 e deri më tani, unë mund t'ju them se që nga momenti i daljes së problematikës së byzylyqeve dhe i identifikimit të saj, e deri më tani, në vitin 2019, janë zhvilluar takime të vazhdueshme me bashkimin e operatorëve, që janë katër kompanitë që prodhojnë byzylyqe, dhe Ministria e Drejtësisë ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm kontroll, pasi Ministria e Drejtësisë ka krijuar një grup pune për të kontrolluar çështjen e byzylyqeve, por ka kërkuar edhe zëvendësimin e atyre byzylyqeve që mund të kenë qenë me defekte.

Sa herë që ne kemi identifikuar problem, nga grupet e punës kemi thirrur bashkimin e operatorëve, për të kërkuar sjelljen e byzylyqeve të reja, për t'iu përgjigjur pikërisht detyrimeve që vendos ligji për mjetet elektronike.

Aktualisht, jemi në situatën kur kemi kërkuar sërish të na sjellin byzylyqet të reja, pa defekte. Me të ardhur byzylyqet e reja, ne do të njoftojmë prokurorinë për aplikimin e masave, në zbatim të ligjit për mjetet elektronike.

Lidhur me numrin total të punonjësve, në mos gaboj, janë 148 punonjës në të gjithë Shqipërinë.

**Ermonela Felaj** – A ka pyetje nga kolegë të tjerë në raport me ligjin?

Po, zoti Harusha!

**Luan Harusha** – Faleminderit, zonja kryetare!

Ky ligj është shumë i domosdoshëm për personat që vuajnë këtë dënim, por kisha një pyetje për qarkun e Shkodrës. Në këtë qark ka rreth 730 presona të dënuar dhe stafi i drejtorisë është shumë i vogël. A keni marrë ndonjë masë për shtimin e personelit për këtë drejtori me 8 specialistë, të cilët punojnë me 730 të dënuar, sepse janë shumë pak?

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Po, zonja zonja Caka.

**Fjoralba Caka** – Ashtu siç është edhe në relacionin shoqërues të projektligjit, projektligji nuk parashikon ndryshime në strukturën aktuale të Shërbimit të Provës. Por ne jemi të hapur për të marrë çdo vlerësim edhe nga institucioni për ta reflektuar më vonë në një

VKM, e cila do të ndryshonte strukturën aktuale në përputhje me nevojat. Pra, projektligji nuk sjell ndryshime në strukturë duke e lënë ashtu siç ka qenë.

**Ermonela Felaj** – Po, zoti Harusha.

**Luan Harusha** – Jam dakord, por a mendoni se këto 8 specialistë mund të kryejnë punën ashtu siç duhet?

**Fjoralba Caka** – Kjo situatë është edhe në degë apo në zyra të tjera territoriale. Tryeza të tilla shërbejnë për të evidentuar problemet dhe ne mund ta diskutojmë edhe më tej, për ta zgjidhur me vendim të Këshillit të Ministrave, pasi struktura mund të ndryshojë vetëm me VKM. Prandaj ne jemi të hapur për çdo lloj sugjerimi.

**Ermonela Felaj** – Nëse mundem të ndërhyj, në projektligj thuhet: “Struktura përcaktohet me urdhër të Kryeministrit”. Prandaj në çdo rast Ministria e Drejtësisë ka detyrimin dhe të drejtën që t’i propozojë Kryeministrit strukturën sipas nevojave dhe ajo të miratohet. Pra, është më e thjeshtë se një vendim i Këshillit të Ministrave.

Po, zonja Dhima!

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja zëvendësministre, për prezantimin!

Unë kam dy pyetje. E para, si e vlerësoni bashkëpunimin me institucionet, si me ato shtetërore apo me private dhe me organizatat jofitimprurëse, të cilat janë brenda dhe jashtë vendit, pasi ky bashkëpunim është shumë i rëndësishëm për realizimin e veprimtarisë suaj?

E dyta, a mendoni se personeli i Shërbimit të Provës në 22 degët e tij është i trajnuar profesionalisht për të kryer detyrën dhe për të realizuar misionin e tij, apo ka nevojë për trajnime apo kurse të tjera? Ju si institucion a keni planifikuar të kryeni trajnime apo kurse të ndryshme profesionale për rritjen e profesionalizmit të personelit të Shërbimit të Provës?

Faleminderit!

**Fjoralba Caka** – Faleminderit për pyetjet!

Unë e çmoj pyetjen tuaj lidhur me bashkëpunimet me institucionet dhe OJF-të brenda vendit, pasi ne duhet të jemi të qartë se nuk duhet të jetë vetëm qeveria, e cila me planet dhe ligjet që merr ndihmon në integrimin e të burgosurve apo të personave që po vuajnë Shërbimin e Provës në jetën sociale dhe ekonomike të vendit, por ka nevojë për të gjithë aktorët. Kjo për të kuptuar se personi që ka vuajtur një dënim nuk duhet të ndëshkohet përjetësisht, por t’i ofrohen të gjitha platformat e mundshme për integrimin e tij në jetën sociale të vendit.

Në këtë kuadër ne vlerësojmë edhe bashkëpunimin me OJF-të si brenda dhe jashtë vendit dhe mund t’ju sjell disa raste. Për shembull, punimet artizanale të grave që po vuajnë dënimin me burg. Pra OJF-të mund të kontribuojnë në vënien në punë të aftësive të këtyre të

burgosurve, në zbulimin e talenteve apo forcimin e aftësive që ata kanë, si dhe në integrimin e tyre më pas në tregun e punës.

Lidhur me pyetjen e dytë, dua t'ju them se personeli ka kryer trajnime. Ne kemi pasur një projekt britanik, ku kemi përfituar nga asistenca britanike si në hartimin e këtij projektligji, por edhe në sistemin tonë penitenciar. Pra, jo vetëm personeli është trajnuar dhe do të trajnohet, por edhe Shkolla e Magjistraturës ofron vazhdimisht trajnime për masat alternative të dënimit, si për prokurorë, ashtu dhe për gjyqtarët, duke i vendosur bashkë të gjithë aktorët ligjzbatues në mirëfunksionimin e shërbimit të provës dhe në zbatimin e masave alternative të dënimit.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Caka!

Po, zoti Ibrahim.

**Edis Ibrahim** – Në lidhje me bashkëpunimin që ka Shërbimi i Provës me institucionet shtetërore apo me organizatat e tjera, dua të theksoj se në vitet 2018 dhe 2019 Ministria e Drejtësisë ka lidhur më shumë se 20 marrëveshje me bashki të ndryshme në vend, në kuadër të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Pra, Shërbimi i Provës ka një rol shumë të rëndësishëm në integrimin dhe riedukimin e të miturve që do të jenë me dënime alternative. Ky projekt ka filluar me Bashkinë e Tiranës, e cila vendosi në dispozicion të Shërbimit të Provës 5 qendra sociale multidisiplinore, ku specialitet e këtij shërbimi do të ndjekin të miturit, jo në zyrat vendore apo në degët territoriale ku ata janë, në ambiente më miqësore për ta. Kjo eksperiencë u ndoq më pas edhe në qytete të tjera, si: Durrësi, Fieri, Vlora, Korça, Elbasani. Ne synojmë që të arrijmë marrëveshje me 61 bashkitë që janë në vend, aty ku ata kanë mundësi të vënë në dispozicion ambiente.

Gjithashtu, Shërbimi i Provës ka një bashkëpunim të mirë me bashkitë në lidhje me trajtimin social të të gjithë personave, por edhe me zyrat për formimin profesional në çdo qark. Pra, ky bashkëpunim vazhdon të jetë i frytshëm, por nevojitet që të zgjerohet.

Në lidhje me trajnimin e stafit, 50 përqind e stafit u rinovua pas vitit 2018, sepse kaluan nëpërmjet DAP-it, prandaj është i nevojshëm trajnimi. Shërbimi i Provës ka një plan trajnimi, të cilin e ka hartuar që në vitin 2018 dhe po e zbaton në 2019. Gjithashtu, ne kemi përfituar edhe nga organizata të ndryshme, si OSBE-ja apo projekti suedez, të cilët në projektet e tyre kanë përfshirë Shërbimin e Provës dhe kanë organizuar trajnime për stafin e saj.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Po, zoti Murrizi!

**Myslim Murrizi** – Duke dëgjuar shpjegimet që dha këshilltari i ministres, në gjykimin tim, numri i atyre që trajtohen nga Shërbimi i Provës është 7500 veta, pra 1,5 herë

më i lartë se numri i atyre që janë në burgje. Çfarë veprash penale përfshihen te ky numër i të dënuarve, i cili është 1,5 herë më i lartë se numri i atyre që vuajnë dënime në burgje?

Në bashkëpunimin me bashkitë, për cilën kategori të dënuarish bëhet fjalë? Unë e di se bashkëpunimin e ka filluar Bashkia e Durrësit me Vangjushin, e cili ishte i pari që punësoi Lulin. Në shembullin e tij i keni kontratat me bashkitë e tjera?

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, ndizni mikrofonin.

**Edis Ibrahimi** – Marrëveshjet që ne kemi nënshkruar me bashkitë janë në kuadër të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pra ne kemi filluar trajtimin...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, për të miturit që dënohen me dënime alternative.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Besoj se do të jeni më të qartë nëse brenda numrit total që ju dhatë, pra 7528 personave, të bëni edhe një shpërndarje të moshave dhe të veprave penale. Pra, sa janë të mitur në këtë shifër? Sa janë të rritur dhe për çfarë veprash bëhet fjalë?

**Edis Ibrahimi** – Nga një statistikë e vitit 2018, nga 7500 persona që janë trajtuar nga Shërbimi i Provës, 290 persona kanë qenë të mitur.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pjesa tjetër janë të rritur meshkuj dhe femra.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, flisni me mikrofon! Ta lemë zotin Ibrahimi të japë përgjigjen dhe më pas mund ta pyesni përsëri për çështje, për të cilat nuk keni marrë ende përgjigje.

Zoti Ibrahimi, a mbaruat me përgjigjet?

**Edis Ibrahimi** - Në lidhje me trajtimin femra – meshkuj për vitin 2018, mund të them se kanë qenë 643 femra të trajtuara me dënime alternative, nga totali 7500, të cilat janë mbikëqyrura nga Shërbimi i Provës. Normalisht, pjesa më e madhe janë meshkuj.

**Ermonela Felaj** – Cila është vepra më e përhapur ndërmjet tyre?

**Edis Ibrahimi** – Ajo është në bazë të masës së dënimit, por më shumë është zbatuar neni 59, ku është bërë pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit. Pjesa tjetër janë qëndrime në shtëpi, ku për vitin 2018 ka pasur 82 vendime. Gjithashtu, për vitin 2018 kemi pasur 254 vendime liri me kusht dhe 1017 punë të detyruar në interes publik.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Unë i dëgjova përgjigjet për pyetjet që ju bëtë. A keni pyetje të tjera?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, zoti Harusha.

**Luan Harusha** – Nuk kam pyetje...

*(Mungesë incizimi.)*

**Ermonela Felaj** – Në komisionin tonë e kemi pasur disa herë drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, edhe stafin e tij, për të raportuar për veprimtarinë e Shërbimit të Provës (ne kemi qenë prezentë edhe në Drejtorinë e Shërbimit të Provës), njëkohësisht edhe në rastet kur kanë ardhur ndryshimet në ligjin për ekzekutimet e vendimeve penale kanë qenë prezentë përfaqësuesit e Shërbimit të Provës.

Një nga problematikat, që ata kanë paraqitur para nesh, por që edhe ne vetë e kemi prekur, është pikërisht mungesa e ambienteve për ushtrimin e funksionit. Meqenëse tani po bëhet një ligj i ri, i cili presupozohet që do ta promovojë më mirë Shërbimin e Provës dhe detyrën e tij në raport me mjediset, a kemi ndonjë gjë të re? A janë përsëri të njëjtat mjedise, apo ministria ka në plan që ta akomodojë më mirë Shërbimin e Provës?

Pyetja ime për zotin Duro është: nga ana praktike, çfarë sjell më mirë ligji, sepse ju drejtoni zyrën më të madhe në vend, që trajton numrin më të madh të personave që përfitojnë nga dënimet alternative? Çfarë sjell më mirë ky ligj? Ju 10 vjet keni funksionuar me një rregullore, sigurisht keni pasur edhe probleme, por shpresoj që të jeni konsultuar me ligjin. Këtë gjë, nga ana praktike, do të doja ta kishim sot si të dhënë prej jush.

**Fjoralba Caka** – Lidhur me pyetjen tuaj, është e vërtetë që mjediset nevojiten të përmirësohen, dhe ky ka qenë një shqetësim edhe i Ministrisë së Drejtësisë. Para se të ndodhnin ndryshimet në ligjin e kadastrës, Ministria e Drejtësisë ka pasur prona në objekt të saj dhe është munduar që në këto prona të akomodojë Shërbimin e Provës, por në vende të tjera, si në Elbasan, në Korçë, në Lushnjë dhe në Vlorë janë marrë ambiente me qira, në mënyrë që Shërbimi i Provës të kishte ambiente të përshtatshme për të përmbushur funksionet që parashikon ligji. Duke e thënë këtë, patjetër që ka nevojë për përmirësim. Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen edhe të donatorëve, por edhe të fondeve nga buxheti i shtetit, në kuadër të gjithë paketës penitenciare, nuk do të mjaftohet thjesht me rishikimet ligjore, por në axhendën e saj ka parashikuar përmirësimin e mëtejshëm të këtyre ambienteve. Nuk e di nëse zoti Ibrahimimi do të shtojë diçka.

**Ermonela Felaj** – Po, patjetër, nëse keni diçka për të shtuar, zoti Ibrahimimi, mund ta thoni.

**Edis Ibrahimimi** – Lidhur me atë që tha zonja zëvendësministre, mund të them se zyrat vendore të Shërbimit të Provës kanë qenë ambiente jo shumë të përshtatshme, por nga viti 2018 në ato zyra vendore, ku Ministria e Drejtësisë e ka pasur të pamundur akomodimin në ambiente që kanë qenë në pronësi të saj, është menduar të merren disa ambiente me qira, që

shërbimi dhe funksionimi i Zyrës së Shërbimit të Provës të ishte sa më i mirë. Të tilla ambiente janë marrë në Korçë, në Elbasan, në Lushnjë, në Vlorë dhe në Shkodër. Në këto qytete, që përmenda, zyrat kanë qenë më problematike dhe ne jemi munduar që momentalisht t'i akomodojmë në ambiente me qira.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, për informacionin!

Zoti Duro, fjala për ju.

**Bernard Duro** – Faleminderit, zonja kryetare!

Për sa i përket pyetjes suaj, ky ligj e ndihmon shumë Shërbimin e Provës edhe në marrëdhënie me institucionet e tjera, si me prokurorinë, me gjykatat, sepse, të them të drejtën, deri tani nuk na kanë parë si aktorë të rëndësishëm. Pas miratimit të këtij ligji, ne do të jemi gati në çdo seancë gjyqësore për të përgatitur raportet e vlerësimit për të dënuarit si në fazën e hetimit, ashtu edhe në fazën e gjykimit, por edhe për të miturit, që është detyrim që në çdo fazë të hetimit dhe gjykimit të të miturve ne duhet të përgatisim një raport. Ky ligj, në fakt, na ka qetësuar, sepse ne tani kemi marrë edhe statusin e nëpunësit civil dhe punonjësit e Shërbimit të Provës ndihen më të mbrojtur.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te miratimi nën për nenin e projektligjit.

Fillojmë me nenin 1, që ka të bëjë me objektin e këtij projektligji. A ka vërejtje, pyetje apo sugjerime nga kolegët për këtë nen? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Misioni i Shërbimit të Provës”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Përkufizime”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 “Parimet e veprimtarisë së Shërbimit të Provës”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 “Organizimi i Shërbimit të Provës”. Shërbimi i Provës organizohet si një institucion publik dhe buxhetor, që është në varësi të ministrit të Drejtësisë, ndërkohë që punonjësit kanë statusin e nëpunësit civil.

Kush është dakord me nenin 5? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 “Funksionet e Shërbimit të Provës”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7, “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8 “Kompetenca tokësore e degëve territoriale”. Nga përfaqësuesit e ministrisë na u sqarua se shpërndarja e 22 degëve ndjek shpërndarjen e gjykatave në vend, që është shumë e arsyeshme.

Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9 “Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës”. A ka pyetje, sugjerime, apo vërejtje për këtë nen? Nuk ka.

Unë kam një ndërhyrje lidhur me këtë nen. Unë shikoj se në nenet më poshtë ju përcaktoni kushtet që duhet të përmbushë personi që do të marrë detyrën e drejtorit të degës territoriale dhe të specialistit të Shërbimit të Provës, ndërkohë që për drejtorin e Përgjithshëm nuk ka asnjë lloj kushti dhe asnjë lloj kriteri. Pra, çfarë kushtesh duhet të përmbushë drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës dhe a ka një mandat të përcaktuar të qëndrimit në detyrë të tij, apo jo? Ndoshta mund të na jepni një shpjegim pse nuk ka një parashikim për këtë në ligj. Për drejtorin e degës ju keni thënë se duhet të zotërojë të paktën një diplomë të nivelit “Master shkencor”, “Master i arteve” apo “Master profesional”. Po ashtu, për specialistin e Shërbimit të Provës keni thënë se duhet të zotërojë diplomë të nivelit “Master profesional” apo të barasvlershme me të, për degët psikologji, drejtësi, punë sociale ose sociologji. Po për drejtorin e Përgjithshëm pse nuk keni parashikuar asnjë kusht dhe asnjë kriter? Si është gjykuar kjo gjë nga ana juaj?

**Edis Ibrahim** - Sepse edhe drejtori i Përgjithshëm është me statusin e nëpunësit civil dhe zgjidhet nga Departamenti i Administratës Publike në konkursin e hapur.

**Ermonela Felaj** – Jam dakord, por disa kushte duhet të ketë, apo jo?.

**Edis Ibrahim** - Kushtet për drejtorët e përgjithshëm, që kanë nivelin TND, janë të përcaktuara te ligji për statusin e nëpunësit civil.

**Ermonela Felaj** – Unë mendoj që për të mos iu referuar një gjëje apo një tjetre do të ishte me vend, edhe për përmbajtjen e ligjit, sepse është një ligj për herë të parë për shërbimin e provës, që ju të përcaktoni kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushë funksionari për të kryer këtë detyrë. Nuk e di nëse kolegët janë dakord me këtë sugjerim.

Miratohet neni 9.

Ne i sugjerojmë Komisionit të Ligjeve të marrë në konsideratë këtë vërejtje në raport me nenin 9.

Kalojmë te neni 10 “Drejtori i Degës Territoriale”.

Kush është dakord me nenin 10?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, zonja Gjebrea.

**Elona Gjebrea** – Duhet ruajtur e njëjta logjikë. Këtu futemi në detaje, që janë 120 kredite, dhe kohëzgjatja është normale, 2 vjet janë të barasvlershme. Për mua, në momentin kur kërkohet një diplomë masteri, mjafton, nuk është nevoja të futemi në detaje, të cilat janë shumë teknike. Një person që ka marrë diplomë masteri ka kriter të mjaftueshëm për të qenë drejtor. E njëjta gjë ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është shumë e detajuar. Nuk është e nevojshme, sepse ndërkohë edhe specialisti futet me master profesional. Drejtori bombardohet me detaje, ndërsa për specialistin kanë përdorur tjetër kriter. Për mendimi tim duhet më shumë logjikë dhe jo detaje.

**Ermonela Felaj** – Më bën sens ndërhyrja e zonjës Gjebrea. Nuk duhet të futemi në detaje kaq të rëndësishme, sepse më pas mungon vetëm emri i drejtorit të Degës Territoriale.

Miratojmë nenin 10 sipas vërejtjes së zonjës Gjebrea, që do t’i referohet Komisionit të Ligjeve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për pikën 2

Stafi i shërbimit të komisionit e ka të regjistruar atë që shpjegoi zonja Gjebrea dhe besoj se do ta zbardhë korrekt.

Kalojmë te neni 11.

Kush është dakord me nenin 11? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12 “Të drejtat dhe ndalimet e punonjësve të Shërbimit të Provës”.

Keni pyetje, vërejtje apo sugjerime për këtë nen?

Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 “Rastet e konfliktit të interesit”.

Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu III i projektit “Mbështetja e Shërbimit të Provës gjatë procesit gjyqësor”, konkretisht në nenin 14 “Detyrimi për të paraqitur raport vlerësimi”.

Kush është dakord me nenin 14? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 “Raporti i Shërbimit të Provës”. Thamë se një nga detyrat më të rëndësishme që bën Shërbimi i Provës është pikërisht ai që lidhet me raportin e vlerësimit për personin, që besoj se e ndihmon gjykatën dhe prokurorinë në punën e tyre.

Kush është dakord me përmbajtjen e këtij neni? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16 “Zbatimi i urdhrit të ekzekutimit”, është një nen i thjeshtë. Për çdo vendim gjykate është prokurori që nxjerr urdhrin e ekzekutimit. Në rastin e dënimeve alternative dhe të masave të tjera, natyrisht, urdhërohet Shërbimi i Provës për të ekzekutuar vendimin në fjalë.

Kush është dakord me nenin 16? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17 “Administrimi i të dhënave gjatë zbatimit të urdhrit të ekzekutimit”. Besoj se është një nen i qartë edhe për shkak të një praktike të gjatë pune dhe të konsoliduar të Shërbimit të Provës.

Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18 “Veprimet që kryhen në zbatim të urdhrit të ekzekutimit”. Keni pyetje apo sugjerime? Nuk keni.

Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19 “Veprimet që kryhen në zbatim të vendimeve të parashikuara në kuadër të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur”. Ne thamë se një nga arsyet që do të çonte domosdoshmërisht në hartimin e këtij projekti është fakti që tanimë kemi një kod Drejtësie Penale për të Mitur dhe Shërbimi i Provës nuk mund të vazhonte të operonte me një akt normativ.

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20 “Detyrimet e të mbikëqyrurit në rast të ndryshimit të vendbanimit” ka të bëjë me një moment për të cilin ne kemi diskutuar edhe më herët te ligji për ekzekutimin e vendimeve penale dhe me aq sa kam mundur të shikoj gjatë ditës së sotme, mendoj se i përfshin.

Kush është dakord me nenin 20? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21 “Përkujdesja për të mbikëqyrurin”. Kush është dakord me nenin 21? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22 “Mbështetja për viktimën”. Nëse Shërbimi i Provës, me funksionimin e vet, ndihmon në riintegrimin në shoqëri të të dënuarit, në të njëjtën kohë ka detyrimin për të ndihmuar dhe për të mbështetur edhe viktimën e një veprë penale.

Kush është dakord me nenin 22? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23 “Mospërmblidhja e detyrimeve të përcaktuara nga gjykata”.

Kush është dakord me nenin 23? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24 “Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë”.

Po, zoti Braho.

**Spartak Braho** – Thuhet se kur Shërbimi i Provës vlerëson se duhen zbatuar rregullat e Konventës Europiane, të lë idenë se Shërbimi i Provës e vlerëson zbatimin e Konventës Europiane, dispozitën dhe rregullat, kur këto dispozita janë të detyrueshme. Mund të bëhet një formulim tjetër, ku Shërbimi i Provës, në zbatim të rregullave të Konventës Europiane për mbikëqyrjen, bashkëpunon me ministrinë.

**Ermonela Felaj** – Vërejtja e zotit Braho është me vend. Ne e kemi detyrim kushtetues. Atë që buron nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut është e detyrueshme për zbatim, sepse jemi pjesë e saj.

Miratohet neni 24 me vërejtjen e zotit Braho.

Kalojmë në kreun e fundit të ligjit “Dispozitat kalimtare”.

Neni 25 “Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave”, në bazë të cilit është miratuar rregullorja që ndihmon në funksionimin e Shërbimit të Provës nga viti 2009 deri më sot.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në momentin KUR të dalë rregullorja e re, vendimi do të shfuqizohet.

Zoti Braho, keni ndërhyrje?

Kush është dakord me nenin 25? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26 afirmon edhe një herë sigurinë për qëndrimin në detyrë të punonjësve të Shërbimit të Provës. Ata janë punonjës të shërbimit civil dhe gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Fakti që do të veprojnë sipas një kuadri tjetër ligjor, në bazë të ligji, nuk ndryshon asgjë për konfigurimin e tyre aktualisht.

Kush është dakord me nenin 26? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27.

Unë kam një pyetje: a ka ndonjë afat për nxjerrjen e këtyre akteve nënligjore? Ministri i Drejtësisë ka një sërë detyrimesh dhe duhet të nxjerrë disa akte nënligjore, por mungon detyrimi për afatin brenda të cilit duhet të zbatohet kjo gjë. Meqenëse nuk është vendosur, ne do të sugjerojmë që në nenin 27 të vihet një afat për nxjerrjen e akteve nënligjore. Ne mendojmë të jetë afati minimal 3-mujor nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 28 “Hyrja në fuqi e ligjit”. Ligji hyn në fuqi në afatin e zakonshëm. Kush është dakord me nenin 28? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Këtu mbyllet miratimi nen për nen.

Vazhdojmë me miratimin në tërësi të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës.

Kolegë, ju falënderoj edhe një herë për bashkëpunimin gjatë ditës së sotme dhe për vërejtjet, të cilat me siguri do t’i paraqiten Komisionit të Ligjeve. Shpresojmë që ato të reflektohen në përmbajtjen e projektligjit!

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me të gjitha sugjerimet që u bënë në komision.

Falënderoj edhe përfaqësuesit e ministrisë!

Punë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**